Zona më e gjerë është në rrezik nga një sërë ngjarjesh të ndryshme përmbytjesh, të shkaktuara nga lumi Seman, përmbytja e kanalit kullues ose përmbytjet sipërfaqësore gjatë reshjeve intensive, për shkak të rrezikut dinamik të përmbytjeve në zonën përreth dhe brishtësisë së rrjetit të kullimit si pasojë e mirëmbajtjes së dobët. Përmirësimet në rrjetin e kullimit brenda Parkut FV do të zvogëlojnë rrezikun e përmbytjeve gjatë fazës së funksionimit.

Ndikimet nga ndryshimi klimatik global në rritjen e përmbytjeve mund të influencojnë zonën e PDA edhe pse kjo pritet të jetë një shqetësim i vogël. Studimet e mëparshme (Pirazzoli, 1986) treguan se ka një rritje të nivelit të detit Adriatik që shkon nga më pak se 1 mm/vit deri në mbi 2 mm/vit, por gjithashtu tregon një tendencë në rritje për si pasojë e ndryshimit të klimës.

E gjithë zona e projektit kullon në drejtim të veriut drejt Kanalit Kullues të Dokollarëve dhe përfundon në Stacionin e Pompimit të Karavastasë, i cili e shkarkon ujin në detin Adriatik. Duke ju referuar të dhënave të

² Atlasi i tokës I Europës (2005). Rrjeti i Byrosë Europiane të Tokës, Komisioni European, 128pp.

³ Atlasi i tokës I Europës (2005). Rrjeti i Byrosë Europiane të Tokës, Komisioni European, 128pp.

mbledhura për përmbytjet nga delta e Semanit⁴ dhe ngritja e nivelit të detit në zonë, zona e projektit nuk është prekur nga përmbytjet për një periudhë prej 100 vitesh dhe nuk pritet të ketë përmbytje brenda zonës së PDA,

Projekti ndodhet në një zonë të qëndrueshme dhe ka mbrojtje nga përmbytjet e detit dhe duna ranore të krijuara nga zona e akumulimit të lumit Seman duke reduktuar ndjeshëm rrezikun e përmbytjeve direkte nga deti dhe ndryshimet në nivelin e detit.

Sipas raportit hidrologjik, thellësia më e madhe e përmbytjeve ka ardhur nga modeli Rain on Grid për hietografinë 24-orëshe të stuhisë me një periudhë kthimi 1 në 100 vjet kur stacioni i pompimit nuk është në punë. Thellësia e përmbytjes arrin në 85 cm. Në këtë rast, kur stacioni i pompimit është jashtë funksioni dhe by-pass i bllokuar, uji nuk mund të shkarkohet në det dhe do të mbyllet në fushë. Ndërsa në rastin e të njëjtës stuhi dhe me stacionin e pompimit në punë me kapacitet të plotë thellësia e ujit është rreth 70 cm dhe kërkon 4-6 ditë për t'u tharë.

Për dy stuhi të tjera, 50 dhe 20 vjet periudha e kthimit, thellësia e ujit është përkatësisht 60 cm dhe 55 cm. Shpejtësitë e përmbytjeve janë nën 0.6 m/s që është nën nivelin që do të kërkonte mbrojtje nga erozioni. Ndërkohë që modeli hidrodinamik i lumit Seman dhe kanalit të Myzeqesë tregon se zona e Studimit nuk është e prirur të përmbytet. Brenda zonës së përmbytjes, lartësia e montimit të kornizave të modulit diellor duhet të projektohet në mënyrë që skaji i poshtëm i modulit të jetë i pastër nga niveli i parashikuar i përmbytjes 1 në 100 vjet (stacioni i pompimit nuk është në punë) në mënyrë që të mos ndikojë në sjelljen ekzistuese të përmbytjeve dhe për të parandaluar dëmtimin e infrastrukturës si rezultat i përmbytjeve. Në rast të një ngjarjeje të rëndësishme përmbytjeje, modulet duhet të rrotullohen për të siguruar hapësirën maksimale nga panelet në tokë për t'i mbajtur ato të pozicionuara shumë mbi nivelin e parashikuar të përmbytjes. E gjithë infrastruktura elektrike, përfshirë inverterët, duhet të vendosen mbi nivelin e përmbytjeve 1 në 100 vjet. Aty ku kërkohet që kabllo të elektrike të ndërtohen nën nivelin e përmbytjeve 1 në 100 vjet, ai duhet të jetë i aftë të zhytet vazhdimisht në ujë.

Ndryshimi i klimës do të ndikojë temperaturën dhe rrezatimin dhe për këtë arsye do të ndryshojë kapacitetin e prodhimit të sistemeve FV. Sistemet FV paraqesin një lidhje lineare negative midis prodhimit të energjisë dhe ndryshimit të temperaturës, ndërsa rritja e rrezatimit diellor është proporcionale me prodhimin e energjisë FV⁵.

Ndryshimi i nivelit të detit u analizua nga Pirazzoli (1986) dhe tregoi se ka një rritje të nivelit të detit Adriatik që varion nga me pak se 1 mm/vit deri në mbi 2 mm/vit, por gjithashtu tregon një tendencë në rritje për si pasojë e ndryshimit të klimës. Për periudhën 1961 – 2003, të dhënat tregojnë një rritje mesatare nga 1.3 në 2.3 mm/vit, ndërsa gjatë periudhës 1993 – 2003 ka patur një rritje mesatare nga 2.4 në 3.8 mm/vit. Në Samitin Botëror të Ndryshimeve Klimatike (ICCP 2007) u raportua se gjatë viteve 1980 – 1999 dhe 2000 – 2009, rritja mesatare e nivelit të detit do të variojë midis 0.18 m – 0.59 m për shkak shkrirjes së akullnajave.

Ngritja e nivelit të detit shkakton ndryshime të pozicionit të vijës bregdetare dhe do të ketë një ndikim shumë të madh në ultësimin pranë detit dhe deltat e lumenjve. Matjet e kryera në detin Adriatik gjatë periudhës 1993 – 2014, tregojnë se vlera maksimale (7.13 +/-1.67 mm/vit) e rritjes së nivelit të detit Adriatik matet në stacionin e Ravenës (Itali), ndërsa vlera minimale (2.48 +/-1.53 mm/vit) matet në Zadar në Kroaci.

3.1.8. Topografia dhe relievi

Elementet kryesore morfologjike të zhvilluara në rajonin Divjakë – Karavasta përfaqësohen nga një zonë e madhe fushore, kodrat e vogla të Divjakës që ndodhen rreth 8.5 km në verilindje të zonës së projektit dhe laguna bregdetare e Karavastasë që shtrihet në veriperëndim, deltat e Semanit dhe Shkumbinit në jugperëndim dhe veriperëndim, respektivisht, dhe dunat e rërës dhe plazhet ranore në perëndim. Tiparet më të rëndësishme morfologjike lidhen me zonën deltaike bregdetare të Karavastasë në veriperëndim të

⁴ ICE-000-P06-V01 Karavasta 140MW – Studim Hidrologjik

⁵ Jerez, S., Tobin, I., Vautard, R. et al. The impact of climate change on photovoltaic power generation in Europe. Nat Commun 6, 10014 (2015). <https://doi.org/10.1038/ncomms10014>

Wild M. (2012) Solar Radiation Versus Climate Change. In: Meyers R.A. (eds) Encyclopedia of Sustainability Science and Technology. Springer, New York, NY. https://doi.org/10.1007/978-1-4419-0851-3_448

zonës së projektit, të cilat janë rezultat i veprimit të regjimit të erës dhe valëve, rrymave detare, shkarkimeve të sedimenteve etj.

Gjeografikisht, zona e Projektit është pjesë e Myzeqesë së Madhe (fusha bujqësore), e cila shtrihet në brigjet e detit Adriatik, në pjesën qendrore të Ultësirës Perëndimore; kufizohet në veri me lumin Shkumbin, në jug me lumin Seman, në lindje me kodrat e Divjakës - Ardenicës dhe në perëndim me detin Adriatik. Ky pozicion gjeografik vlerësohet për lehtësimin e shërbimeve dhe aktiviteteve të komunitetit njerëzor që jeton në komunë dhe fshatrat e saj.

3.2. Mjedi biologjik

Vlerësimi i biodiversitetit përfshin studime kërkimore dhe në terren të habitateve, florës, jovertebrorëve, peshqve, amfibëve, zvarranikëve shpendëve dhe gjitarëve. Në total 352 lloje të bimëve vaskulare janë vëzhguar gjatë survejimeve në terren. Rreth 100 lloje ishin nën statusin e mbrojtjes nga Bashkimi Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN), por asnjë prej tyre nuk u gjet brenda gjurmës së Projektit. Studimi i Habitatëve në zonën e projektit ka treguar që nuk ka ansjë lloj habitati të listuar në Aneksin I të Direktivës së Habitatëve.

Projekti, përfshirë impiantin diellor VV dhe gjurmën e LTTL-së, kalon përmes një peizazhi Mesdhetar tokash bujqësore, toka të braktisura, kullota, e livadhe. Vegetacioni në zonën e impiantit diellor PV dominohet nga habitat i kripur kallamishtesh, dhe livadhe me vlera të ulëta biodiversiteti. Gjurma e LTTL-së përfshin një zonë më të madhe dhe me mjedis më të larmishëm për sa i përket diversitetit të habitatit dhe specieve biologjike.

Rreth 34 specie të gjitarëve u vëzhguan në zonën më të gjerë të studimit. Prezenca e specieve të mbrojtura si vidrat (*Lutra lutra*), vjedulla (*Meles meles*), dhe çakalli (*Canis aureus*) u konfirmua brenda zonës së zhvillimit të projektit (ZZHP) dhe kanalet e kullimit në afërsi, përfshirë lumin e Semanit. Herpetofauna e ZZHP-së dhe LTTL-së përbëhet nga 6 amfibë (nga 16 specie amfibësh të regjistruar në Shqipëri) dhe 23 zvarranikë (nga 43 specie të raportuar në Shqipëri). Dy specie bretkosash (*Rana dalmatina* dhe *Hyla arborea*) janë si aneks IV të HD-së së BE-së, ndërsa një specie (*Pelophylax shqipericus*) është një specie endemike e Shqipërisë dhe Malit të Zi. Prezenca e 11 specieve të zvarranikëve u konfirmua.

Studimet bazë zbuluan se një numër specimesh të faunës me status të mbrojtur u vëzhguan në zonën më të gjerë të studimit. Kjo përfshin tetë (8) specie gjitarësh, katë specie zvarranikësh dhe tri specie amfibësh.

Një total prej 125 specie zogjsh u vëzhguan në zonën e projektit, tre nga ato janë të Rrezikuara Globalisht, katër specie janë të rrezikuara në Europë, ndërsa 19 specie janë të rrezikuara në nivel kombëtar.

Në linjë me kërkeat e SP6 të IFC-së dhe KP6 të BERZH-it për Habitatin Kritik (HK), kualifikimin e biodiversitetit, Karakteristikat e Biodiversitetit Prioritar, dhe Zonat me Biodiversitet Kyç të Lagunës së Karavaastasë dhe Zonën me Biodiversitet dhe Zogj të Rëndësishëm, është zhvilluar një Plan Menaxhimi i Biodiversitetit (PMB) për të detajuar masat zbutëse dhe monitoruese që do të zbatohen gjatë ndërtimit dhe operimit të projektit në mënyrë që të shmangen dhe minimizohen ndikimet dhe të restaurohet habitatit për këto karakteristika dhe për të verifikuar nivelin e ndikimeve të ndodhura.

Gjithashtu, është zhvilluar Një Draft i Planit të Veprimit për Biodiversitetin (PVB) për të kualifikuar impaktet shtesë mbi biodiversitetin prioritar të identifikuar dhe për të propozuar masat mbrojtëse që do të ndihmonin projektin të përmbushin angazhimin e fitimit neto për Habitatin Kritik, dhe angazhimet për zero humbje neto për Karakteristikat e Biodiversitetit Prioritar, dhe promovimin e synimeve mbrojtëse dhe menaxhimin efektiv të Zonës Kyçe të Biodiversitetit/Zonës së Rëndësishme të Biodiversitetit, gjithashtu në linjë me rekomandimet e organizatës BirdLife International.

3.2.1. Zona e mbrojtur

Zona e projektit është jashtë por në afërsi të ngushticës jug-perëndimore të Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta. Ky Park Kombëtar konsiderohet si një nga zonat natyrore më të rëndësishme të Shqipërisë.

Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta ka një madhësi prej 22,230 hektarësh. Ai u përcaktua si Park Kombëtar në vitin 2007 përmes një Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 687, date 19.10.2007. Parku përfaqësohet nga habitatet e rëndësishëm si më poshtë:

- Zonë Pyjore (pyje, pyje të rralla, pyje dhe shkurre aluviale, rryllëzim, tokë ujore me vegjation dhe pyll) 5310.00 Ha (hektarë);
- Zonë bujqësore (tokë bujqësore, vreshta, ullishte dhe pemëtore) 9078.42 Ha.
- Zonë ujore (laguna, lumenj dhe kënetë) 6408.90 Ha;
- Zonë jo-produktive (tokë ranore dhe sheshe) 1120.71 Ha
- Zonë urbane me tokë bujqësore të përzier, pemë dhe vreshta 312.21 Ha.

Zonat e Rëndësishme të Zogjve dhe Biodiversitetit (ZRB) të lagunës së Karavastës dhe Zonat Kyçe të Biodiversitetit (ZKB) Shkumbin-Seman, mbulojnë pjesën më të madhe të Parkut Kombëtar dhe ndodhen mes Lumit Shkumbin në Veri dhe Kanalit të Myzeqesë dhe Lumit Seman në Jug. Pjesa lindore e kompleksit rrethohet nga kodrat e Divjakës ndërsa kufiri perëndimor përbëhet nga Deti Adriatik.

Rezerva Natyrore Pishë-Poro është një kënetë bregdetare që gjendet në veri të Lumit Vjosë dhe rreth 14.5 km në jug-perëndim të ZZHP-së.

“Vjosë-Narta” u përcaktua si një Zonë Peizazhi e Mbrojtur nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 680, datë 22.10.2004. Ajo ndodhet rreth 20 km në jug të ZZHP-së. E përcaktuar si një monument natyror i kategorisë III të mbrojtjes së IUCN-së 2002⁶, “Kurora e Semanit” përfaqëson një pyll bregor që shtrihet përgjatë Lumit Seman.

Monumenti i natyrës mbulon një zonë prej rreth 44 ha, e shquar për biodiversitetin e saj, dhe ndodhet 6 km në juglindje të ZZHP-së dhe rreth 3 km në lindje të LTTL-së.

3.2.2. Habitatet Kritik

U përfundua një Vlerësim i Habitatit Kritik (VHK) për të kuptuar më mire karakteristikat e biodiversitetit të cilat mund të nxisin Standartin e Performancës nr 6 (SP6) të IFC-së dhe Kërkesën e Performancës nr. 6 të BERZH (KP6). Analiza është bazuar në interpretimin e databazave globale dhe rajonale, literaturës së disponueshme dhe të dhënat nga terreni të VNMS-së dhe VHK-së. Ai konfirmoi që:

- Pesë specie përmbushin prapën e Kriterëve 1-3/Kriteret II-IV të Habitatit Kritik (HK) për kënetat dhe habitatet ujore brenda impiantit FV përgjatë gjurmës së linjës së transmetimit – katër specie peshqish dhe Brekosit Shqiptarë të Ujit;
- Pjesa e mbetur e zonës së Projektit përmbush përkufizimin e IFC-së për habitatin e modifikuar – me përjashtim të një zone të vogël prej Salix alba dhe Populus Alba përgjatë lumit të Semanit mes shtyllave 10-15 të linjës së transmetimit. Këto habitate gjithashtu përmbushin përkufizimin e BERZH për ‘habitatin e rrezikuar’ dhe konsiderohen si PBF. Megjithatë, asnjë nga këto habitate nuk janë përcaktuar si të rrezikuara nga Lista e Kuqe e IUCN-së të Vlerësimit të Ekosistemeve për Europën dhe prandaj nuk përmbushin përcaktimet e IFC-së/BERZH për HK.
- Dy habitate dhe 49 specie janë identifikuar si Karakteristika Kyçe të Biodiversitetit, sic është përkufizuar në KP6 të BERZH.
- Gjurma e Projektit mbivendoset me një zonë të njohur ndërkombëtarisht (Zonën Kyçe të Biodiversitetit të Karavastës). ZKB-ja gjithashtu përmbush përcaktimin e BERZH për KBK-në (Karakteristikat e Biodiversitetit Kyç). Habitatet kënetore brenda Zonës Kyçe të Biodiversitetit janë HK për 2 specie zogjsh, megjithatë këto habitate nuk mbivendosen me zonën e Projektit dhe në këtë rast nuk aplikohen kërkesat e SP6/KP6 as për Pelikanin e Dalmatit dhe as për “Pigmy Cormorant”.

⁶ <https://www.eea.europa.eu/data-and-maps/explore-interactive-maps/european-protected-areas-1>

- Prezenca e specieve që i kualifikojnë zonat si HK nuk do të thote që një projekt do të ketë ndikim domethënës mbi këto specie.




Figura 6: Habitatat Natyror dhe i Modifikuar në Zonat Pyjore dhe Tokësore të Studimit

Zbutja e ndikimeve në lidhje me habitatet do të menaxhohet nëpërmjet zhvillimit të një PMMS-je dhe PVB-je, të cilat do të specifikojnë masat e duhura për menaxhimin e pastrimit të zonës së kantierit dhe aktivitetet e gërmimit, trajnimin e stafit për ruajtjen e vlerave të biodiversitetit dhe menaxhimin e tokës dhe mbetjeve si në impiantin diellor FV ashtu edhe përgjatë LTTL-së, si edhe infrastrukturën përkatëse, si kambi dhe çdo rrugë hyrëse/aksesi me gjatësi të vogël, etj.

3.3. Kushtet bazë sociale dhe ekonomike

Fshatrat më të afërt me parkun FV janë Hastukas dhe Ndërnenas të cilët shtrihen përkatësisht rreth 800 m dhe 1500 m në lindje të zonës së projektit. Ndërsa, shtëpitë e banuara më të afërta duke përfshirë disa magazina ndodhen 40-50 m larg nga rruga kryesore hyrëse që të çon në zonën e parkut FV dhe 390 m larg nga vetë ky i fundit.

Impianti do të zhvillohet në territoret e NjA Libofshe dhe Remas ndërsa LTTL do të kryqëzojë territoret e NjA Topoje, Qendër dhe Dërmenas. Zona e drejtpërdrejtë e studimit të projektit për vlerësimin bazë social përfshin vendbanimet pranë dhe brenda parkut FV dhe zonës së prekur nga LTTL.

Krahasuar të dhënat nga Censusi 2011⁷ me ato të regjistruara realisht në Gjendjen Civile⁸, 38,54% më pak banorë janë regjistruar në Censusin për bashkinë Fier dhe 35,82% më pak banorë për bashkinë Divjakë. Ky mund të konsiderohet si një numër i mundshëm i atyre që kanë migruar.

Popullsia në zonat rurale ndryshoi ndjeshëm pas vitit 1990. Për shkak të mungesës së investimeve dhe mundësive për punësim, një numër i madh njerëzish u larguan nga zonat rurale për të gjetur punë në qytete.

Bashkia e Fierit përfshin zonat më të rëndësishme bujqësore të vendit, si dhe një pjesë të konsiderueshme të industrisë që lidhet me përpunimin e naftës në rajonin e Fierit. Më shumë se gjysma e popullsisë së bashkisë jeton në zonat rurale, gjë që tregon rëndësinë e sektorit të bujqësisë në jetën ekonomike të bashkisë. Prodhimi bujqësor i kësaj zone është i larmishëm nga drithërat deri tek perimet, pjeperi, blegtoria dhe nënproduktet e saj. Bashkia ka një vijë të konsiderueshme bregdetare që shtrihet nga lumi Vjosa deri në grykëderdhjen e lumit Seman në kufijtë e Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta. Gjithashtu, një atraksion i rëndësishëm turistik është Parku Arkeologjik i Apolonisë, së bashku me objektet e tjera të trashëgimisë kulturore.

Bashkia e Divjakës përbëhet pothuajse tërësisht nga zona rurale. Bashkia ndodhet në një zonë tërësisht rurale dhe pjellore, ndërsa pjesë e territorit të kësaj bashkie është edhe parku kombëtar Divjakë – Karavasta, si dhe plazhi i Divjakës. Bujqësia është aktiviteti kryesor ekonomik. Produktet kryesore bujqësore janë bostani, i cili shitet në tregun vendas dhe eksportohet në shumë vende të Evropës Qendrore dhe Lindore. Divjaka ka perspektiva të mira për zhvillimin e turizmit bregdetar dhe ekoturizmit. Vitet e fundit vëzhgimi i shpendëve është shfaqur si një atraksion i rëndësishëm turistik për shkak të pranisë së një kolonie të vogël pelikani të rrezikuar në lagunën e Karavastës. Turizmi është i zhvilluar më së shumti për turistët ditorë dhe kuzhina është e fokusuar tek produktet e peshkut, për të cilat zona është e njohur në të gjithë vendin.

Aktivitetet ekonomike të zonës së studimit të projektit janë të fokusuara kryesisht në bujqësi. Të dhënat e analizuara për zonën e projektit tregojnë se nga kryefamiljarët (të konsideruar si garantuesi kryesor i të ardhurave) 46.4% janë të angazhuar në veprimtari bujqësore dhe blegtorale. Një tjetër 10% raportojnë se janë të punësuar në sektorin privat, sektorin publik ose të vetëpunësuar dhe 34.6% e të anketuarve janë pensionistë. Gjithashtu, 7.4% e të anketuarve janë të papunë dhe në mënyrë aktive kërkojnë punë.

Për sa i përket punësimit të anëtarëve të familjes, bujqësia është ende punëdhënësi më i madh me 26.78%, krahasuar me sektorët e tjerë. Kur punojnë si fermerë në fshat, banorët më së shumti përmbushin nevojat e familjes së tyre.

Zona e projektit karakterizohet nga një reliev uniformisht i sheshtë me mungesë të mbulesës së konsiderueshme pyjore ose shkurreve. Përdorimi i tokës në Zonën më të gjerë të Projektit dominohet pothuajse tërësisht nga të mbjellat, të cilat paraqiten si një mozaik (parceta-parceta në formë mozaiku), karakteristike kjo e fushave drejtkëndore. Parcelat e tokës përdoren edhe për kullota nga fermerët e zonës për shkak të vështirësisë së mbjelljes së kulturave në zonat e kripura.

Vetë lokacioni i projektit të parkut FV është kryesisht i kripur për shkak të afërsisë me bregun e detit dhe depërtimit të ujërave të detit, dhe për këtë arsye nuk përdoret për rritjen e kulturave. Mirëpo, gjatë angazhimit në fshatin Hasturkas, u raportua se një pjesë e vogël e tokës përdoret për kullotje, por nuk ka asnjë përdorues specifik të identifikuar.

Janë identifikuar gjithsej tetë shërbime potenciale të ekosistemit⁹ përgjatë ose në afërsi të gjurmës së LTTL; Këta përfshijnë:

- Blegtoria

⁷ INSTAT 2011 CENSUS <http://www.instat.gov.al/>

⁸ <https://aam.org.al/bashkia-fier/>

⁹ Shërbimet e Ekosistemit përkufizohen si "përfitimet që njerëzit marrin nga ekosistemet". Përveç sigurimit të shërbimeve apo të mirave si ushqimi, druri dhe materiale të tjera të papërpunuara, bimë, kafshë, kërpudha dhe mikroorganizma, ekosistemi gjithashtu siguron shërbime të domosdoshme rregullatore si pllenimin e bimëve, parandalimin e erozionit të tokës dhe pastrimin e ujit, dhe një sërë shërbimesh kulturore si argëtimi dhe ndienjen e përkatësisë tek një vend.

Burimi: : <https://www.iucn.org/commissions/commission-ecosystem-management/our-work/cems-thematic-groups/ecosystem-services>

- Prodhimi i mjaltit
- Peshkimi
- Gjuetia
- Pjalmimi
- Proceset hidrologjike
- Etike/Rekreative dhe turistike
- Habitatet gjysmë natyrore dhe natyrore

Pas një procesi shqyrtimi, pesë shërbimet e mëposhtme u zgjodhën për një vlerësim më të detajuar:

- Blegtoria
- Prodhimi i mjaltit
- Proceset hidrologjike
- Rekreacion dhe turizëm
- Habitat gjysmë natyror dhe natyror

Mbi 90.4% e familjeve të zonës kultivojnë tokën e tyre dhe fitojnë të mbjella për nevojat e tyre familjare ose ndonjëherë edhe për shitje. Megjithatë, shumica e kulturave janë kultura sezonale dhe kjo sigurisht që sjell të ardhura të paqëndrueshme. Të anketuarit raportojnë kultivim të produkteve bujqësore në masën 69,1 %, ndërsa pjesa tjetër kultivohet me kultura për qëllime blegtorale. Për sa i përket blegtorisë, 70,9 % e familjeve raportuan se zotërojnë bagëti.

Individët e cënueshëm mund të preken më shumë nga procesi i marrjes së tokës dhe mund të kenë mundësi të kufizuara në pretendimin apo përfitimin nga kompensimi. Në këtë kontekst, projekti, veçanërisht për marrjen e tokës për LTTL-në, në vlerësimin e individëve të cënueshëm ka përfshirë por nuk është kufizuar në:

- Personat me aftësi të kufizuara, qoftë mendërisht apo fizikisht;
- Të moshuarit, veçanërisht kur jetojnë vetëm dhe/ose nuk kanë rrjet solidariteti i cili mund t'i mbështesë;
- Familjet me kryefamiljar femër dhe të cilat jetojnë me burime të kufizuara;
- Familjet pa burime ose me burime të kufizuara;
- Gratë e veja dhe jetimët;
- Familjet të cilat preken nga Projekti por që nuk i kanë regjistruar të drejtat e tyre të pronës, duke i rrezikuar që të mos marrin kompensim (ku mund të përfshihen qiramarrësit informalë dhe fermerët që ndajnë të mbjellat; dhe zaptues të tjerë pa të drejta ligjore mbi pronën); dhe
- Fëmijët që jetojnë në ndërtesa pranë rrugëve të aksesit apo rrugët e transportit që kalojnë pranë shkollave lokale

Skanimi dhe identifikimi i personave të cënueshëm në lidhje me marrjen e tokës janë përcaktuar në Planin e Rikuperimit të Jetesës (LRP).

Pothuajse të gjitha habitatet e hasura brenda dhe në afërsi të ZZHP-së ka të ngjarë të jenë degraduar në një farë mase përmes modifikimit njerëzor. Prerja intensive, mbikullotja dhe bujqësia intensive kanë çuar në një thjeshtësim të relievit dhe një reduktim të biodiversitetit, të cilat kanë ndikuar në shërbime të ndryshme të shërbimeve të ekosistemit, si kontrolli i dëmtuesve natyrorë dhe pllenimi.

Brenda zonës së parkut FV ka një shteg rrugor që përdoret nga fshatarët dhe barinjtë gjatë pranverës dhe verës për të siguruar akses në parcelat bujqësore në anën tjetër të parkut. Gjithashtu, ky shteg përdoret si një rrugë e shkurtër që lidh rrugën hyrëse që të çon në bregdet. Rruga është e paasfaltuar, me baltë dhe e pamundur për t'u kaluar gjatë dhe/ose pas ditëve me shi. Megjithatë, ndërprerja e përkohshme e aksesit në këtë shteg nuk do t'i kufizojë banorët të arrijnë në anën tjetër të parkut FV pasi ata kanë alternativa të tjera rrugore.

Së bashku me ndërhyrjet për përmirësimin e kushteve të rrugëve dhe urave për vendin e parkut FV, do të duhet të përmirësohen ose ndërtohen një sërë rrugësh të përkohshme për instalimin e shtyllave dhe LTTL-së. Shumica e këtyre rrugëve janë "rrugë bujqësore", rrugë hyrëse që u mundësojnë fermerëve të arrijnë në parcelat përkatëse. Uji i pijshëm që vjen nga ujësjellësi raportohet nga banorët e zonës si i pasigurt dhe jo i përdorshëm si ujë i pijshëm.

Në shumicën e fshatrave ka shkolla fillore dhe të mesme, ndërsa shkollat e mesme janë të vendosura në fshatrat më të mëdha ku ndodhen Njësitë Administrative. Qendrat shëndetësore ofrojnë shërbimet bazë të ndihmës së parë. Shumica e tyre nuk kanë staf dhe pajisje. Spitali ndodhet në qytetin e Fierit.

3.4. Trashëgimia Kulturore

Asnjë vend i trashëgimisë kulturore (i prekshëm apo i paprekshëm) nuk është identifikuar në zonën e Projektit bazuar në literaturën e disponueshme përfshirë faqen e internetit të Institutit Kombëtar për Trashëgiminë Kulturore dhe investigimet në terren. Asnjë Trashëgimi Kulturore e Paprekshme nuk u identifikua apo raportua nga takimet me komunitetet lokale, Intervistat me Informatorin Kyç, bashkitë, etj. Monumenti i kulturës më i afërt me ZZHP dhe gjurmën e LTTL-së janë Kulla e Prgut – Monument i Kategorisë së Parë (521 m nga ZZHP), DHE Kisha e Shën Marinës (686 m nga ZZHK). Gjithashtu gjendet një kishë ortodokse 1.2 km nga kantieri, e quajtur Kisha "Ungjillëzimi i Hyjëlidës" në Hastukas.

Asnjë nga komunitetet lokale nuk identifikoi ndonjë praktikë tradicionale të rëndësishme që mund të prekej.

3.5. Angazhimi i palëve të interesit

Aktivitetet e angazhimit me Palët e interesit si dhe procesit të blerjes së tokës dhe rikuperimit të mjeteve të jetesës deri në këtë fazë të projektit janë kryer si pjesë e procesit të VNMS-së, sipas standardeve shqiptare dhe standardeve të huadhënësve. Të gjitha palët e interesuara janë angazhuar që në fazat e hershme të projektit përmes takimeve individuale, shpërndarjes së fletëpalosjeve informuese mbi projektin. Angazhimi është ndërmarrë gjatë fazave të fushëveprimit dhe VNMS-së dhe gjatë studimit të LRP-së, ku të gjitha komunitetet që jetojnë përgjatë linjave të transmetimit janë angazhuar gjerësisht dhe janë informuar për procesin e përvetësimit të tokës, por edhe për ndikimet që lidhen me projektin. Takime shtesë do të mbahen për zbulimin e paketës së LRP-së.

Metodologjia e PAPI (Plani i Angazimit të Palëve të Interesit) është zhvilluar për të përshkruar parimet dhe metodat që duhet të rregullojnë angazhimin e Voltalia me të gjithë aktorët ekzistues dhe potencialë gjatë të gjitha fazave të projektit. Është përcaktuar se të gjithë aktorët përkatës do të ftohen të marrin pjesë në një sërë takimesh, në faza të ndryshme të procesit, në mënyrë që të informohen në lidhje me gjetjet dhe rekomandimet e ekipit studimor. Parimet kryesore që do të udhëheqin gjatë gjithë angazhimit të palëve të interesuara janë si më poshtë:

- **Proaktive:** Për të shmangur çdo rrezik të mundshëm që mund të lindë në marrëdhëniet tona me palët e interesuara.
- **Transparente:** Kompania do të angazhohet me palët e interesuara në një proces të hapur, me synime, qëllime, llogaridhënie, pritshmëri dhe kufizime transparente.
- **Në kohë:** Kompania do të angazhohet me palët e interesuara në avancimin e aktiviteteve të konsultimit dhe vendimmarrjes, në mënyrë që të lejojë kohë të mjaftueshme për dialog kuptimplotë, konsultim dhe modifikime.
- **Gjithëpërfshirëse:** Kompania do të sigurojë që angazhimi jonë me palët e interesuara të jetë

përfshirës në përfaqësimin e pikëpamjeve, duke përfshirë gratë, informatorët kryesorë dhe grupet e fokusit.

- **E aksesueshme:** Kompania do të shpërndajë informacionin në mënyra dhe vendndodhje që lehtësojnë aksesin e palëve të interesuara.
- **Falas:** Angazhimi i Kompanisë me palët e interesuara nuk do të ndikohet nga asnjë lloj manipulimi, frikësimi dhe shtrëngimi.

Procesi i angazhimit të palëve të interesuara filloji në fazën më të hershme të planifikimit të projektit dhe do të vazhdojë gjatë gjithë jetës së projektit, me fokus në:

- Angazhimi gjatë përgatitjes/dizajnimit të projektit (përfshirë zbulimin);
- Angazhimi në fazën e para-ndërtimit dhe ndërtimit;
- Angazhimi gjatë funksionimit të projektit;
- Angazhimi gjatë fazës së çmontimit;

Plani i Angazhimit të Palëve të Interesit është publikuar në faqen e internetit të Projektit:

<https://karavastasolar.com/stakeholder-engagement-report/>

4. Ndikimet kryesore mjedisore dhe sociale dhe masat shoqëruese zbutëse

Faza e ndërtimit të parkut fotovoltaik (FV) dhe LTTL (linjë transmetimi ajrore) në përgjithësi përfaqësojnë ndikimet kryesore në mjedis dhe komunitet. Ndikimet kryesore për fazën e ndërtimit dhe masat zbutëse shoqëruese paraqiten në tabelën e mëposhtme.

4.1. Faza e Ndërtimit

Komponenti	Pasqyrë e ndikimit	Ndikimet e Mundshme	Përmbledhje e masave kryesore zbutëse të propozuara	Rëndësia e ndikimit (pas masave zbutëse)
Ajri	Emetimet e përkohshme të gazrave të shkarkimit në atmosferë nga automjetet e përfshira në ndërtimin e projektit (d.m.th., shkarkimet nga ekskavatorët, buldozerët, kamionët, automjetet/makinat); Shkaktimi i pluhurit gjatë punimeve të ndërtimit dhe lëvizja e makinave.	degratimi i cilësisë së ajrit për shkak të emetimit të ndotësve	- Zhvillimi dhe zbatimi i një PMMSN dhe procedura për menaxhimin e pluhurit, i cili do të përfshijë masat e duhura për menaxhimin e pastrimit të kantierit, aktivitetet e gërmimit dhe ndërtimit për minimizimin e gjenerimit të pluhurit dhe parandalimin e përhapjes së tij. - Mënyra më efektive për menaxhimin dhe parandalimin e gjenerimit të pluhurit dhe emetimet e mjeteve dhe trafikun është përmes kontrollit efektiv të burimeve që gjenerojnë pluhur; disa masa specifike zbutëse për të siguruar që këto burime janë minimizuar: - Grumbullimi i dherave dhe materialeve të tjera tokësore do të minimizohen nëpërmjet koordinimit të aktiviteteve të gërmimit; - Në rastet e pluhurit të dukshëm që krijohet nga automjetet dhe aktivitetet e tjera, zbatimi i masave të spërkatjes me ujë për të reduktuar pluhurin. - Zhvillimi i një Plani të Menaxhimit të Trafikut për Ndërtimin (PMTN)	<i>I moderuar - impianti FV dhe LTTL</i>

Komponenti	Pasqyrë e ndikimit	Ndikimet e Mundshme	Përmbledhje e masave kryesore zbutëse të propozuara	Rëndësia e ndikimit (pas masave zbutëse)
			- Të gjitha makineritë dhe pajisjet e ndërtimit të mirëmbahen në gjendje të mirë pune dhe të mos lihen në punë kur nuk janë në përdorim. - Vëzhgimi i nivelit të pluhurit dhe sasinë e pluhurit që bie mbi ndërtesat pranë (200 m) kantierit të ndërtimit dhe marrjen e masave për të reduktuar gjenerimin e pluhurit nëse ka pluhur të tepërt mbi sipërfaqe.	
		•		
Dhera / tokë	gërmimet për themelet, rimbushja e tokës dhe ndërtimi i rrugëve të aksesit Rrjedhje ose derdhje e vajrave dhe karburanteve nga mjetet/makineritë e ndërtimit, magazinimi jo i duhur i mbetjeve të vajrave, karburanteve, kimikateve, ujërat e zeye etj. Rrezik nga materialet e tepërta për shkak të gërmimeve	prishja e strukturës së shtresës së dheut ndotje e mjedisit nga mbetjet e materialeve	Disa masa zbutëse që lidhen me çrregullimin e shtesës së sipërme të dheut përfshijnë: jeqja e sipërfaqes së dheut dhe ruajtja e pjesës pjellore të sipërfaqes së dheut, e ndjekur nga rikultivimi i tokës dhe restaurimi pas zbatimit të punimeve. Masat zbutëse për parandalimin e ndotjes së dheut përfshijnë: - mirëmbajtja e rregullt e mjeteve dhe makinerive; - zbatimi i praktikave të mira në përdorimin dhe ruajtjen e kimikateve dhe menaxhimin e mbetjeve - - Përdorimi i të gjithë materialit të gërmuar brenda kantierit për reliev/peisazh dhe restaurim, në masën më të madhe të mundshme. - Pirgjet të vendosen brenda zonave të përcaktuara të grumbullimit të dherave, - Pirgjet të stabilizohen me gardhe, gjeotekstile/llum ose mbjellje nëse do të qëndrojnë të zhveshura për më shumë se 3 muaj.	<i>I vogël - impianti FV dhe LTTL</i>

Komponenti	Pasqyrë e ndikimit	Ndikimet e Mundshme	Përmbledhje e masave kryesore zbutëse të propozuara	Rëndësia e ndikimit (pas masave zbutëse)
			- Të shmanget ngjeshja e rezervave për të lejuar vendosjen e bimësisë gjatë rehabilitimit/restaurimit.	
Hidrologjia	gërmimet për themelet e kullave të LTTL-së, derdhje apo rrjedhje e vajrave dhe karburanteve nga mjetet e ndërtimit dhe makineritë e tjera. Magazinim jo i duhur i mbetjeve të vajrave, karburanteve dhe kimikate të tjera dhe menaxhim i dobët i mbetjeve dhe ujërave të përdorura në njësitë e akomodimit.	Ndotje e sipërfaqes dhe ujërave tokësore, sedimentimi dhe erozioni Brenda ZZHP dhe kanalet e kullimit/ujitjes. modifikim i structures së ujitjes dhe kullimit	- zbatimi i praktikave në mira në menaxhimin e gërmimeve, përdorim dhe ruajtje e kimikateve dhe menaxhim i mbetjeve - Ruajtja e structures hidrologjike rreth impiantit FV dhe zonat e punimeve për shtyllat e LTTL-së, dhe ruajtja e një discipline sa më shumë të jetë e mundur e rrjedhës natyrale/ekzistuese e ujërave, thellësisë së kanaleve dhe pjerrësia e tokës. - Të zhvillohet një procedure e kontrollit të sedimenteve.	I vogël - impianti FV dhe LTTL
Relievi dhe pamja vizuale	Gërmim i përkohshëm i tokës natyrore; pastrim i vegjetacionit Ruajtje e përkohshme e materialeve të ndërtimit, makinerisë dhe rrugët e aksesit të përkohshëm, ndërtimi i impiantit FV, themeleve të kullave të LTTL-së dhe ngritja e kullave.	Ndryshimi i përkohshëm në reliev dhe ndërhyrjet vizuale.	• Zhvillimi dhe implementimi i praktikave të mira të ndërtimit dhe ruajtjes së materialeve (si pjesë e PMMSN-së) për të kontrolluar aktivitetet e ndërtimit dhe mbajtja e pastër e hapësirave të ndërtimit. • Minimizimi dhe heqja e shtesës së sipërme të dheut dhe kufizimi vetëm në zonat ku është e nevojshme; pastrimi i kujdesshëm i vegjetacionit për të siguruar që të pastrohet vetëm një pjesë e kufizuar e vegjetacionit brenda zonave të gjurmës së projektit që do të lehtësojnë aksesin për ndërtim dhe aktivitetet e punimeve. • Sistemimi i kantierit të ndërtimit gjatë gjithë aktivitetëve të punimeve; matrialet, mbetjet dhe makineritë të mbahen brenda zonave që janë rrethuar dhe kanë sinjalistikën e duhur.	I vogël - impianti FV dhe LTTL

Komponenti	Pasqyrë e ndikimit	Ndikimet e Mundshme	Përmbledhje e masave kryesore zbutëse të propozuara	Rëndësia e ndikimit (pas masave zbutëse)
			- Rehabilitimi dhe restaurimi i zonave të prekura sa më shpejtë që të jetë e mundur, jo domosdoshmërisht duke pritur përfundimin e fazës së ndërtimit; - Sigurimi i konsultimit të vazhdueshëm me komunitetet lokale gjatë fazës së ndërtimit	
Zhurma dhe vibrimi (dridhjet)	Transporti i ngarkesave për ndërtim; Aktivitete të lëvizjes së dherave; Lëvizja e mjeteve të ndërtimit; Ndërtimi i rrugëve të aksesit; Aktivitete ndërtimore të impiantit FV; Ngritja e shtyllave dhe përcjellësve		- Mirëmbajtja e pajisjeve, dhe monitorim i emetimit të zhurmës, menaxhuar nëpërmjet zhvillimit të PMMSN për fazën e ndërtimit - Zhvillimi dhe zbatimi i PMSHSP për mbrojtjen e punëtorëve dhe pajisja me Pajisje të Mbrojtjes Personale të mjaftueshme. - Zhvillimi dhe zbatimi i PMTK-së (shih masat zbutëse të propozuara për menaxhimin e trafikut) - Njoftimi paraprak i banorëve vendas në rastin e punimeve të rëndësishme të ndërtimit që gjenerojnë zhurmë dhe/ose vibrime; - Kufizimi i aktiviteteve ndërtimore gjatë ditës dhe gjatë ditëve të javës;	I vogël - impianti FV dhe LTTL
Trafiku	Gjenerimi i trafikut të ndërtimit.	Siguria e komunitetit dhe fuqisë punëtore dhe qarkullimi i trafikut lokal.	- Zhvillimi dhe zbastimi i Planit të Menaxhimit të Trafikut të Ndërtimit. - Zbatimi i përmirësimeve të rrugëve aty ku është e nevojshme - riparimi ose restaurimi i rrjetit rrugor nëse dëmtohet nga automjetet e Projektit. - Njoftimi nëpërmjet qeverisjes vendore i banorëve në zonat e prekura për të koordinuar fluksin e trafikut për përdoruesit lokalë; - Transporti të mbrohet dhe patrullohet nga mjete sigurie dhe shoqërim i mundshëm nga policia për të garantuar sigurinë e përdoruesve të tjerë të rrugës dhe informimin	I moderuar në i vogël pas zbutjes

Komponenti	Pasqyrë e ndikimit	Ndikimet e Mundshme	Përmbledhje e masave kryesore zbutëse të propozuara	Rëndësia e ndikimit (pas masave zbutëse)
			e autoritetit përkatës për kamionët e mbingarkuar në segmentin rrugor kombëtar Durrës – Mbrostar, të përdoret gjithashtu edhe për segmentin rural Mbrostar – Libofshë – Agim – Ndërnenas – Kandier ose Babunjë – Agim – Ndërnenas – Kantier. - Trajnimi i drejtuesve të mjeteve për sigurinë rrugore dhe kodin e etikës. - Program ndërgjegjësimi për rrezikun nga trafiku duke përfshirë specifikisht fëmijet dhe personat e cenueshëm si audiencën e synuar - Marrja në konsideratë e punës me faza për të siguruar që të ruhet akses lokal. - Vendosja e kufijve të shpejtësisë, veçanërisht në zonat e populluara. - Mirëmbajtja e automjeteve dhe përfshirja e detajeve mbi inspektimet. - Zero tolerancë për alkoolin dhe drogat ilegale. - Monitorimi dhe vlerësimi i incidenteve në trafik dhe transport.	
Mbetjet	Aktivitetet e përgjithshme të ndërtimit. Mbetjet e prodhuara nga forca e punës Mirëmbajtje e dobët e ambienteve	Hedhje e përkohshme e materialit të gërmuar ndikim vizual i mbetjeve të pa sistemuara;	- Zhvillimi dhe zbatimi i një Plani për Menaxhimin e Mbetjeve për fazën e ndërtimit; - Shmangia e rimbushjes me karburant në kantier që të parandalohen derdhjet e karburantit. Nëse nuk është e mundur do të zhvillohen procedura për të shmangur rrjedhjet aksidentale, siç janë govatat e rrjedhjeve dhe cisternat për karburantin dhe mbetjet kimike - Sigurimi i një zone të dedikuar dhe të përshtatshme për ruajtjen e mbetjeve.	<i>I moderuar në i vogël pas zbutjes</i>

Komponenti	Pasqyrë e ndikimit	Ndikimet e Mundshme	Përmbledhje e masave kryesore zbutëse të propozuara	Rëndësia e ndikimit (pas masave zbutëse)
		ndikim mbi burimet e dheut nga menaxhimi i dobët i materialeve të rrezikshme	- Zbatimi i praktikave të duhura për grumbullimin e mbetjeve në burim, përdorimi ku është praktike, dhe riciklimi i mbetjeve nga operatorët e regjistruar. - Trajtimi dhe magazinimi i duhur i mbetjeve të rrezikshme për grumbullimin dhe asgjësimin e licencuar nga operatori i regjistruar.	
Habitatet dhe zonat e mbrojtura	Punë pastrimi e zonës për heqjen e dherave dhe bimësisë sipërfaqësore. Ndotja e kanaleve të kullimit mund ta transferojnë ndotjen në zonat e mbrojtura Menaxhimi i dobët i mbetjeve dhe ujërave të përdorura, eliminimi jo në mënyrën e duhur i materialit të gërmuar. Mirëmbajtja dhe përmirësimi i kanaleve kulluese. Hedhja e gabuar e materialit të gërmimit. Menaxhimi i dobët i mbetjeve të ngurta dhe ujërave të zeza të krijuara në kampet e përkohshme të ndërtimit.	ndikime të mundshme negative mbi habitatet dhe zonat e mbrojtura	- Humbja e habitatit “1310 Salicornia dhe the bimë të tjera sezonale që konolizojnë tokën dhe rërën që do të preken nga impianti FV. Kjo mund të përfshijë mbjelljen e bimësisë natyrore në zonat pranë. - Skema e rrjetit/modelit të ujitjes dhe kullimit rreth zonës së parkut FV dhe zonave të punës për shtyllat LTTL nuk duhet të ndryshohen, por të mbahen të disiplinuar dhe funksionale në masën maksimale të mundshme me rrjedhën natyrore/ekzistuese të ujit, - Kufizimi i aktiviteteve të pastrimit të zonës vetëm në ato zona ku kjo kërkohet - Kryerja e një studimi para ndërtimit në lokacione të veçanta kyçe (receptorë të ndjeshëm ekologjikë por edhe shërbime sociale/kulturore/ekosistemike) të projektit përpara fillimit të punimeve të ndërtimit; - Kjo mund të përfshijë mbjelljen e bimësisë vendase në këto zona ngjitur. - Të minimizohet humbja e habitatit në masën e mundshme, zonat e planifikuara për pastrimin e habitatit dhe tokës të demarkohen dhe hartohen paraprakisht dhe personeli të informohet se çdo aktivitet jashtë zonave të përcaktuara do të ndalohe	<i>I vogël - impianti FV dhe LTTL</i>

Komponenti	Pasqyrë e ndikimit	Ndikimet e Mundshme	Përmbledhje e masave kryesore zbutëse të propozuara	Rëndësia e ndikimit (pas masave zbutëse)
			rreptësisht, përveç hyrjes dhe daljes përgjatë rrugëve të përcaktuara të hyrjes. - Zonat e ndjeshme në kuptimin mjedisor dhe habitatet kritike rreth zonës së projektit do të shënjohen qartësisht si “zona të ndaluara”. - Për Projektin do të zhvillohen kontrole për zjarret, duke përfshirë ndalimin nga projekti të djegies në ambjent të hapur të mbeturinave nga komunitetet lokale; procedurat specifike të reagimit emergjent të zhvilluara për menaxhimin e zjarreve dhe vendosjen e shuarësve të zjarrit aty ku kërkohet. - Sigurimi i zbatimit të masave të duhura për menaxhimin e aktiviteteve të pastrimit dhe gjurmimit, si dhe menaxhimin e tokës dhe mbetjeve si brenda ZZHP ashtu edhe përgjatë LTTL-së; - Për më tepër, Zhvilluesi do të zhvillojë një Plan të Menaxhimit të Biodiversitetit dhe Restaurimit (PMBR), duke mbuluar si fazën e ndërtimit ashtu edhe atë të funksionimit të projektit.	
Bimësia dhe Flora	Ndikimi në florën lokale, duke përfshirë speciet e rralla për shkak të pastrimit të tokës në kantieret e ndërtimit (Parku FV dhe linja e transmetimit)	Ndikim në florën vendase, përfshirë speciet e rralla	zhvillimi dhe zbatimi i Planit të Menaxhimit të Biodiversitetit (PMB), duke mbuluar si fazën e ndërtimit ashtu edhe fazën e operimit të projektit; PMB-ja do të identifikojë masat për rehabilitimin e kantierit pas	<i>I vogël - impianti FV dhe LTTL</i>

Komponenti	Pasqyrë e ndikimit	Ndikimet e Mundshme	Përmbledhje e masave kryesore zbutëse të propozuara	Rëndësia e ndikimit (pas masave zbutëse)
			ndërtimit, përfshirë rivendosjen e bimëve vendase brenda ZZHP=së që mbështesin kompensimin e biodiversitetit; - Sesione trajnimi dhe ndërgjegjësimi të punëtorëve në lidhje me mbrojtjen e florës lokale. - Verifikime rutinë për të siguruar që pastrimi i bimësisë është kufizuar vetëm në zonat e përcaktuara. Gjithashtu do të kryhen verifikime periodike nga inxhinierët mbikëqyrës.	
	Speciet Invazive të Huaja	Ndryshime të habitateve ekzistuese dhe ekosistemit për shkak të specieve invazive të huaja	Një protokoll i specieve invazive të huaja do të zhvillohet (nga një ekolog me eksperiencë) brenda PMB-së dhe do të zbatohet për të minimizuar rrezikun e transferimit apo prurjes së specieve invazive të huaja në zonën e projektit.	I papërfillshëm – impianti FV dhe LTTL
Fauna tokësore dhe avifauna	Aktivitetet e ndërtimit që përfshijnë pastrimin e bimësisë, germimin e dherave, lëvizjen e automjeteve ose pajisjeve mbi rrugë dhe terren, ngarkimin dhe shkarkimin e materialeve. Gjuetia pa leje, vrasja me dashje e kafshëve.	Lëndimi ose vdekshmëria e faunës dhe avifaunës. shqetësim i faunës dhe fragmentim i habitateve	- Zhvillimi dhe zbatimi i një PMB që mbulon ndërtimin dhe përfshin identifikimin dhe zbatimin e masave për përmirësimin e biodiversitetit; - Kryerja e një studimi/vëzhgimi para-ndërtimor dhe një kontroll i specieve dhe habitateve kyçe, përpara punimeve të ndërtimit, demarkacion i zonës dhe instalim i shenjave paralajmëruese për punëtorët. - Shmangia e punëve ndërtimore gjatë sezonit të shumimit – nga fundi i Marsit deri në mes të Gushtit, shmangia e punimeve gjatë natës, dhe sigurimi që aktivitetet e punimeve nuk kryhen jashtë zonave të përcaktuara të projektit; - Sesione trajnimi dhe ndërgjegjësimi të punëtorëve në lidhje me mbrojtjen e faunës lokale.	I vogël - impianti FV dhe LTTL

Komponenti	Pasqyrë e ndikimit	Ndikimet e Mundshme	Përmbledhje e masave kryesore zbutëse të propozuara	Rëndësia e ndikimit (pas masave zbutëse)
			- Vendosja e kalimeve të përkohshme ose të përhershme që fauna të kalojë rrugët; - Përpara fillimit të punimeve, një ekspert do të ndërmarrë kontrolle paraprake të pastrimit të habitateve kyçe që mund të preken, bimësia do të pastrohet brenda gjurmës së projektit për të shmangur shkaktimin e shqetësimit ose dëmtimit të specieve të faunës (d.m.th., lakuriqëve të natës) dhe zogjve folezues. - Aktivitetet e ndërtimit nuk do të ndërmerren në muzg, agim dhe natë për të shmangur shqetësimin e faunës së natës dhe krepuskulare (d.m.th., speciet e faunës me status të mbrojtur, lakuriqët nate, etj.). - Pastrimi i bimësisë brenda gjurmës së projektit do të ndërmerret në mënyrë progresive dhe të ndjeshme për të mundësuar që fauna të largohet nga zona e punimeve, të shpërndahet në habitatet përreth dhe të shmangë izolimin e faunës në zona të fragmentuara të habitatit. - Kodi i sjelljes që ndalon gjuetinë pa leje ose vrasjen e qëllimshme të kafshëve. - Do të zbatohen kufijtë e reduktuar të shpejtësisë së automjeteve të projektit. - Sigurimi që gërmimet të mos bëhen kurthe për kafshët. - Minimizimi i përdorimit të ndriçimit brenda ZZHP-së dhe zonave të tjera të ndërtimit, dhe aty ku nevojitet ndriçimi, të sigurohet që ndriçimi të jetë i drejtuar.	
Përvetësimi i tokës,	Humbje e përkohshme dhe e përhershme e tokës bujqësore, veçanërisht për LTTL.	Ndikimet në mjetet e jetesës - humbje e	Zhvillimi dhe zbatimi i një Plani të Rikuperimit të Jetesës (LRP) që do të menaxhojë ndikimet ekonomike mbi fermerët e prekur nga ndërtimi i LTTL-së. LRP-ja do të	<i>I vogël - impianti FV dhe LTTL</i>

Komponenti	Pasqyrë e ndikimit	Ndikimet e Mundshme	Përmbledhje e masave kryesore zbutëse të propozuara	Rëndësia e ndikimit (pas masave zbutëse)
shfrytëzimi dhe mjetet e jetesës		mundshme e të ardhurave.	respektojë kërkesat kombëtare dhe ato të SP5 të IFC-së dhe KP5 të BERZH. Plani përfshin elementet e mëposhtëm: • Shmangia sa të jetë e mundur e pozicionimit të kantierit të projektit në tokë të kultifuar apo tokë me prezencë të pemëve frutore apo asete të tjera; minimizimi i tokës së zënë gjatë ndërtimit • Të sigurohet akses për barinjtë dhe aktivitetet e tjera të kullotjes përmes impiantit FV; • Sigurimi i kompensimit të drejtë për përdorimin e tokës dhe të mbjellat si për pronarët ashtu edhe për përdoruesit e tokës; • Mbështetja e grupeve dhe individëve të cënueshme në kompletimin e dokumentacionit të nevojshëm për marrjen e certifikatës së pronësisë të tokës; • Dhënia e kompensimit në kohë për asetet e humbura me vlerën e plotë të zëvendësimit; • Zhvillimi dhe zbatimi i një procesi konsultimesh me banorët vendas të prekur nga projekti dhe palë të tjera të interesit; • Restaurim i plotë i tokës së përdorur për të siguruar që të dorëzohet në gjendjen e saj të mëparshme; dhe zhvillimi i planeve të duhura të rikuperimit të jetesës atëherë kur mjetet e jetesës janë prekur në mënyrë domethënëse dhe kompensimi në para nuk është i mjaftueshëm. •	

Komponenti	Pasqyrë e ndikimit	Ndikimet e Mundshme	Përmbledhje e masave kryesore zbutëse të propozuara	Rëndësia e ndikimit (pas masave zbutëse)
Punësimi	Mundësi punësimi për punime ndërtimi.	Rritja e mundësive të punësimit - Ndikim pozitiv për komunitetet.	Kontraktori duhet të zhvillojë dhe zbatojë një Plan të Menaxhimit të Punësimit dhe Forcës së Punës Vendase (PMFPV) që të maksimizojë përdorimin e forcës vendase të punës dhe përfitimet e komuniteteve vendase, si edhe prioritizimin e punësimit të individëve të cënueshëm dhe grave. Referojuni VNMS-së për masat zbutëse të rekomanduara. • prioritizimi i punësimit të individëve dhe grupeve të cënueshme; • sigurimi që prioritet të kenë bizneset e drejtuara nga gratë gjatë procesit të prokurimit; • sigurimi që të zbatohet “Kodi i Sjelljes dhe Udhëzimi i Etikës” i Voltalias edhe për zinxhirin e furnizimit, që do të thotë të gjithë kontraktorët, nën-kontraktorët dhe furnitorët duhet ta respektojnë atë; Në mënyrë që të rriten mundësitë e punësimit për gratë, Voltalia duhet të marrë masat e mëposhtme: - ofrimi i mundësive të barabarta të trajnimit për gratë dhe burrat; trajnime në terren gjatë fazës së ndërtimit edhe përmes kontraktorëve/nën-kontraktorëve; - përcaktimi i numrit të personave që duhet të jenë gra për intervistat e një pozicioni të ri pune. •	Mesatar pozitiv – Parku FV dhe LTTL
Infrastruktura dhe Shërbimet Komunitare	Aktivitetet e punimeve dhe dëmet e paqëllimshme	Mundësi e degradimit dhe ndërprerjes së shërbimeve	• Zhvillimi dhe zbatimi i praktikave të mira të ndërtimit (pjesë e PMMSN-së) për të kontrolluar aktivitetet e ndërtimit dhe shmangur dhe minimizuar ndikimet në infrastrukturën dhe shërbimet lokale;	I vogël - impianti FV dhe LTTL

Komponenti	Pasqyrë e ndikimit	Ndikimet e Mundshme	Përmbledhje e masave kryesore zbutëse të propozuara	Rëndësia e ndikimit (pas masave zbutëse)
		komunitare dhe infrastrukturës	Koordinim i ngushtë me autoritetet dhe komunitetet vendase rreth shqetësimeve në infrastrukturë (mbyllja e rrugëve, shpërndarja e ujit, shpërndarja e energjisë) që mund të shkaktohen nga aktivitetet e ndërtimit	
Shëndeti dhe Siguria në Punë (SHSP)	Aktivitetet e ndërtimit paraqesin rreziqe për shëndetin dhe sigurinë (SH&S) Emetimi i pluhurit, zhurmës dhe vibrimeve Akses i paautorizuar dhe vandalizëm	ndikime të mundshme mbi shëndetin dhe sigurinë e komunitetit rreziqe mbi shëndetin në punë dhe sigurinë Risk i dhunës dhe ngacmimeve me bazë gjinore (DhNBGj)	- Zhvillimi dhe zbatimi i një Plani Menaxhimi i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë për t'u kujdesur për shëndetin dhe sigurinë e punonjësve dhe të mbulojë të gjitha çështjet e shëndetit dhe sigurisë, përgatitjen për përgjigjen ndaj emergjencave, menaxhimi i incidenteve dhe katastrofave, identifikimi dhe menaxhimi i rrisqeve dhe rreziqeve që lidhen me vendin e punës, etj.; - Trajnimi dhe ndërgjegjësimi i forcës së punës për të kuptuar ngacmimet seksuale në vendin e punës, dhe përgjigjen ndaj aludimeve për ngacmim seksual në vendin e punës; si edhe përgjigjen ndaj aludimeve për ngacmim seksuale me bazë gjinore të punonjësve dhe kontraktorëve ndaj komuniteteve të prekura; emërimi i një zyrtari ndërlidhës me komunitetin i cili do të menaxhojë çështjet e lidhura me ngacmimet me bazë gjinore. Referojuni VNMS-së për të gjitha masat zbutëse të rekomanduara.	I vogël - impianti FV dhe LTTL
Trashëgimia kulturore	Nuk ka objekte të njohura në zonën e Projektit me rëndësi kulturore ose arkeologjike.	dëmtime të mundshme të objekteve kulturore dhe arkeologjike, të	Zhvillimi dhe zbatimi i një Plani Menaxhimi për Trashëgiminë Kulturore (PMTK) për të siguruar mekanizma për identifikimin, mbrojtjen dhe menaxhimin e gjetjeve të trashëgimnisë kulturore gjatë	i papërfillshëm impianti FV dhe LTTL

Komponenti	Pasqyrë e ndikimit	Ndikimet e Mundshme	Përmbledhje e masave kryesore zbutëse të propozuara	Rëndësia e ndikimit (pas masave zbutëse)
		cilat mund të zbulohen gjatë punimeve në tokë gjatë ndërtimit.	ndërtimit, në mënyrë që të shmangen të gjitha dëmet e mundshme të burimeve dhe aseteve kulturore. - Kryerja e një vëzhgimi para-ndërtimor në vende kyçe përpara fillimit të punimeve të ndërtimit; - Zhvillimi dhe zbatimi i një plani të procedurës së gjetjeve të rastësishme në rast zbulimi të rastësishëm arkeologjik.	

4.2. Faza e operimit

Parqet fotovoltaikejanëpasive në natyrë dhe nuk gjenerojnë mbetje të konsiderueshme, emetime në ajër, ndotje në ujë ose zhurmë dhe përgjithësisht konsiderohen të kenë një ndikim të kufizuar në mjedis dhe komunitetet përreth. Më poshtë jepet një përmbledhje e ndikimeve të identifikuar dhe masave zbutëse përkatëse për të minimizuar çdo ndikim të mbetur.

Komponenti	Pasqyrë e ndikimit	Ndikimet e mundshme	Përmbledhje e masave kryesore zbutëse të propozuara	Rëndësia e ndikimit
Faza e operimit				

Komponenti	Pasqyrë e ndikimit	Ndikimet e mundshme	Përmbledhje e masave kryesore zbutëse të propozuara	Rëndësia e ndikimit
Marrja dhe përdorimi i tokës dhe mjetet e jetesës	Humbje e përhershme e tokës bujqësore për zonën e impiantit FV dhe shtyllat e LTTL-së.	Ndikime në mjetet e jetesës – humbje e mundshme e të ardhurave	Megjithëse me pak gjasë, menaxhimi i çdo nevojë të përkohshme apo ndikim në tokë që kërkohet për mirëmbajtjen e faciliteteve të projektit, duke ndjekur të njëjtat procedura si para ndërtimit; Shfrytëzimi i Mekanizmit të Ankesave për të mbështetur familjet të cilat mund të ndikohen nga punimet e mirëmbajtjes gjatë fazës së operimit, në mënyrë që të adresohet çdo pretendim tek OST, i cili do të jetë zotëruesi i vetëm i LTTL-së pas ndërtimit të saj.	<i>i papërfillshëm impianti FV dhe LTTL</i>
Relievi dhe pamja vizuale	Prania e paneleve FV dhe linja e transmetimit. Prania e zonave të restauruara dhe rehabilituara	ndryshime afatgjata të peizazhit një objekt madhor i ri vizual në peizazh për një numër të vogël banorësh vendas. ndriçim dhe shkëlqim i shkaktuar nga drita e dillit që reflektohet në panelet diellore.	- të gjitha mbjelljet zëvendësuese duhet të mbrohen siç duhet, të mirëmbahen dhe të monitorohen për të paktën 5 vite. - Përkujdesje pas-ndërtimore i të gjitha zonave të restauruara dhe rehabilituara - Të gjitha masat zbutëse the menaxhuese të procesit të restaurimit të zonave të prekura nga projekti do të përfshihen në Planin e Menaxhimit të Biodiversitetit (PMB).	<i>I vogël - impianti FV dhe LTTL</i>
Receptorët fizikë (cilësia e ajrit, dheut, hidrologjia)	Vizita të rastësishme tek impianti FV për të kryer inspektime dhe aktivitete të mirëmbajtjes	Gjenerim i pluhurit emetime të mjeteve rrjedhje vaji/karburanti nga mjetet ose makineritë	Zhvillimi dhe zbatimi i një Kornize për Menaxhimin Mjedisor dhe Social për fazën e operimit, përfshirë specifikime për praktika të mira të punës në lidhje me mirëmbajtjen e mjeteve dhe makinerive, menaxhimin e trafikut, përdorim i duhur i burimeve; përdorim, ruajtje dhe menaxhim i kimikateve, etj.;	<i>i papërfillshëm impianti FV dhe LTTL</i>

Komponenti	Pasqyrë e ndikimit	Ndikimet e mundshme	Përmbledhje e masave kryesore zbutëse të propozuara	Rëndësia e ndikimit
			Reduktim i kërkesës për ujë nga projekti duke përdorur teknika të pastrimit kimik mujor, dhe përdorimi i larjes me uje vetëm çdo tre muaj. Instalimi dhe përdorimi i pajisjeve të përdorimit të ujit të shiut dhe avullit duke ndaluar ekstraktimin e ujit nëntokësor apo sipërfaqësor për aktivitetet e operimit të projektit	
Ndryshimet Klimatike	N/A	Ndikimi i mundshëm në pajisje dhe personel për shkak të rritjes së ngjarjeve ekstreme të motit.	Të sigurohet që ndryshimet e mundshme në kushtet klimatike të merren parasysh kur vendosen kushtet e projektimit në terma të temperaturave maksimale dhe minimale, ngarkesës së erës dhe shiut, me sistemin e kullimit dhe themelet e ndërtesave bazuar në të paktën 1 në 100 vjet reshje / raste të përmbytjeve.: • Shmangia ose minimizimi i përdorimit të SF6 • Alternativa të SF6, me potencial të ulët të ngrohjes globale	I papërfillshëm – Parku FV
Receptorët biologjikë (përfshirë avifaunën)	Vizita të rastësishme në impiantin FV dhe LTTL-në për të kryer inspektime dhe aktivitete të mirëmbajtjes	ndikim i mjeteve të operimit mbi florën dhe faunën vendase dëme të mundshme të florës dhe faunës nga kimikatet e përdorura gjatë mirëmbajtjes	• Zhvillimi dhe zbatimi i një PMMS-je dhe PMB-je që specifikojnë masat e duhura për menaxhimin e aktiviteteve të mirëmbajtjes, trajnime dhe ndërgjegjësim i stafit për ruajtjen e vlerave të biodiversitetit, dhe menaxhimi i mbetjeve dhe i dherave si në impiantin diellor ashtu edhe përgjatë LTTL-së, si edhe infrastruktura e lidhur me të, etj.; • Shmangia e dëmeve potenciale mbi faunën vendase duke përdorur vetëm rrugët e përcaktuara të aksesit, menaxhim	I papërfillshëm – Parku FV dhe LTTL

Komponenti	Pasqyrë e ndikimit	Ndikimet e mundshme	Përmbledhje e masave kryesore zbutëse të propozuara	Rëndësia e ndikimit
			i trafikut dhe përdorim i duhur i bojërave dhe kimikateve; - Identifikimi dhe zbatimi i masave për rritjen e biodiversitetit dhe sigurimi i monitorimit të vazhdueshëm të komponentëve të biodiversitetit aty pranë. - Identifikimi dhe zbatimi i masave të mbështetjes së biodiversitetit dhe sigurimi i fushës së veprimit për monitorimin e vazhdueshëm të biodiversitetit - Sigurimi i aksesit të faunës brenda zonës së parkut diellor (nën rrethim për të lejuar speciet e vogla të faunës të vazhdojnë në lëvizin lirisht përmes parkut); - Kultivimi i specieve specifike të bimëve (p.sh. bimë mjekësore) të cilat ofrojnë një efekt ftohës të mirë poshtë paneleve diellore. - Aplikimi i masave mbrojtëse për zogjtë: teknika vizuale të devijimit të shpendëve, përdorimi i kornizave me ngjyrë alumini për të reduktuar ndikimin mbi zogjtë. - Përdorimi i pesticideve për menaxhimin e specieve invazive të huaja do të jetë nën kontroll të rreptë dhe do të përdoren sipas nevojës. Asnjë agjent kimik i identifikuar si i ndaluar nuk do të përdoret, dhe kur është e mundur do preferohet përdorimi i mjeteve mekanike.	

Komponenti	Pasqyrë e ndikimit	Ndikimet e mundshme	Përmbledhje e masave kryesore zbutëse të propozuara	Rëndësia e ndikimit
Mbetjet	Vizita të herëpashershme të mirëmbajtjes.	Gjenerimi i mbetjeve elektrike dhe ambalazheve.	- zhvillimi dhe zbatimi i i Planit të Menaxhimit të Mbetjeve (PMM) në përputhje me legjislacionin shqiptare që do të përfshijë përcaktime për eliminimi e mbetjeve të rrezikshme dhe të parrezikshme përmes kompanive/nën-kontraktorëve të specializuar për eliminimin e mbetjeve. .	I papërfillshëm – Parku FV dhe LTTL
Punësimi	Mundësi punësimi për punë operimi/mirëmbajtjeje.	Rritja e mundësive të punësimit - Ndikim pozitiv për komunitetet.	- Zhvillimi dhe zbatimi një politike për Burimet Njerëzore që maksimizon përdoriin e forcës së punës vendase dhe përfitimet e komuniteteve lokale si edhe priorizimi i punësimit të personave të cenueshëm dhe grave, pa diskriminim dhe mundësi të barabarta për të gjithë punonjësit. - Voltalia do të kontrollojë dhe monitorojë aktivitetet që lidhen me veprimet e ndërtuesve për aspektin social, shëndetësor, të sigurisë, trashëgiminë kulturore dhe punësimin në Projekt. - Zbatimi i një mekanizmi ankesash i hapur për punëtorët që janë pjesë e stafit ashtu edhe për ata që nuk janë pjesë e stafit. Referojuni VNMS-së për të gjitha masat zbutëse të rekomanduara. .	Pozitiv i vogël deri mesatar – Parku FV
Shëndeti dhe Siguria	Shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e impiantit diellor;	Ndikime të mundshme në shëndetin e banorëve vendas: Mundësi të kontaktit me rrymën;	Zhvillimi dhe zbatimi i një Plani Menaxhimi Shëndetit dhe Sigurisë në Punë, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare;	I papërfillshëm për impiantin FV, i vogël për LTTL-në.

Komponenti	Pasqyrë e ndikimit	Ndikimet e mundshme	Përmbledhje e masave kryesore zbutëse të propozuara	Rëndësia e ndikimit
	Shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e LTTL-së; Gjenerimi i elektricitetit dhe fushës magnetike përreth kablllove përgjatë gjurmës së LTTL-së.	- Fusha elektromagnetike; - Rrufe dhe zjare dhe - Çështje që lidhen me aksesin e paautorizuar dhe vandalizmin.	- Ofrimi i informacionit për fermerët dhe punonjësit për të reduktuar ekspozimin e mundshëm nën LTTL-në, si edhe praktika të sigurisë në punë; - Aplikimi i teknikave për të parandaluar rreziqet e kontaktit me rrymën përfshirë: përdorimi i sinjaleve, barrierave, dhe sinjalet edukuese për publikun që të shmanget kontakti i publikut me pajisjet e rrezikshme, tokëzimi i objekteve rrymë përcjellëse (p.sh. rrethimeve apo strukturave të tjera metalike) të instaluar në afërsi të linjave të tensionit, për të parandaluar shokun; Sigurimi i sistemeve automatike të detektimit të zjarrit etj. - Monitorim i rregullt nga OST për të verifikuar lidhjet e paligjshme apo shkeljen e kufizimeve nga pronarët dhe përdoruesit e tokës.	

5. Kuadri i Menaxhimit dhe Monitorimit Mjedisor dhe Social

Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS) është zhvilluar që të sigurojë një udhëzues për Zhvilluesin e Projektit – “Karavasta Solar shpk” (Pronar i Projektit) dhe Kontraktorin EPC, në formulimin e sistemeve, planeve dhe procedurave të duhura të menaxhimit për të siguruar përputhshmëri me kërkesat Mjedisore dhe Sociale (M&S) kombëtare dhe të huadhënësve. Kërkesat e përcaktuara në PMMS të projektit pasues përfshihen në dokumentacionin kontraktual me palët përkatëse, sipas rastit, për të siguruar qartësi dhe përkushtim kundrejt detyrimeve të Kontraktorit në lidhje me menaxhimin mjedisor dhe social, shendetin dhe sigurinë.

Menaxhimi i ndikimeve dhe mundësive në fazat përkatëse të zhvillimit të projektit duhet të konsiderohet në PMMS, nga projektimi deri te mobilizimi dhe ndërtimi dhe deri në fazën operative.

PMMS do të shërbejë për të ofruar një kornizë për SMMS dhe do të përshkruajë aspektet e ndryshme të menaxhimit M&S të Projektit siç përshkruhet më poshtë:

Rolet dhe përgjegjësitë e palëve dhe individëve kyç për menaxhimin M&S të projektit.

Proceset e monitorimit dhe raportimit të kërkuara për të siguruar zbatimin dhe efikasitetin e duhur të planeve dhe procedurave të menaxhimit. Këto procese janë gjithashtu të nevojshme për të përmbushur kërkesat kombëtare dhe të huadhënësve, si dhe për të promovuar transparencën për të gjithë aktorët e projektit.

6. Qasje për zhvendosjen dhe rivendosjen e mjeteve të jetesës

6.1. Hyrje

Sipas rezultateve të studimit bazë, dhënia me qira e tokës në pronësi private është e rrallë në zonë dhe për këtë arsye gjasat për ekzistencën e përdoruesve të tokës, të cilët nuk janë pronarë, janë të vogla. Në çdo rast, Plan i Rikuperimit të Mjeteve të Jetesës (PRMJ) që do të zhvillohet për Projektin do të sigurojë që të gjithë përdoruesit e tokës të prekur nga projekti, përfshirë ata që nuk janë pronarë të tokës, do të kompensohen për humbjet e të korrave në vlerën e plotë të zëvendësimit, kullotave ose pyjeve. Përdoruesit shtetërorë të tokës do të kompensohen për humbjen e të korrave dhe/ose kullotave.

Toka që do të merret në mënyrë të përhershme, do të jepet me qira përkohësisht ose do t'i nënshtrohet servitutit, do t'u kompensohet pronarëve dhe përdoruesve të tokës në përputhje me indikacionet e PRMJ-së, për t'u përgatitur në përputhje me Legjislacionin Kombëtar dhe standardet e BERZH-it. Për më tepër, kompensimet do të sigurohen kur ndikimet e projektit do të ndodhin në të korrat, pemët, kullotat dhe asetet e tjera të pranishme brenda gjurmës së projektit, si për tokën e blerë ashtu edhe për tokën e marrë me qira. PRMJ do të zhvillohet, duke përfshirë dokumentet dhe planet mbështetëse, përpara ndërtimit dhe para veprimeve të zhvendosjes.

6.2. Përgjegjësitë organizative

Një ekip social do të formohet për të menaxhuar çështjet e rikuperimit të mjeteve të jetesës si dhe çështjet e kompensimit.

Menaxhmenti i Karavasta Solar shpk do të jetë përgjegjës për funksionimin e këtij ekipi, kryerjen e sondazheve socio-ekonomike para ndërtimit të zonave që mund të ndikohen nga projekti, duke vlerësuar ndikimet e mundshme sociale të opsioneve të projektit; përgatitjen e një profili përfituesish për secilin opsion; përgatitjen e një programi për monitorimin dhe vlerësimin e përfitimeve dhe ndikimeve të projektit para dhe pas ndërtimit.

Do të zhvillohet një Plan i Investimit në Komunitet për të siguruar marrëdhënie të mira me komunitetet fqinje, për të kompensuar ndikimet jo-specifike komunitare dhe për të ndarë përfitimet.

Ky plan do të mbulojë të gjithë zonën e ZZHP-së dhe LTTL-së dhe do të zbatohet gjatë ndërtimit dhe përgjatë 5 viteve të para të fazës së shfrytëzimit. Buxheti do të caktohet çdo vit nga të ardhurat e projektit.

ZNK do të komunikojë rregullisht me palët e interesuara lokale dhe familjet e tjera të prekura nga projekti, fshatrat, komunitetet dhe autoritetet qeveritare për të adresuar çështjet socio-ekonomike në lidhje me planet e rikuperimit të jetesës, dokumentimi i familjeve ekzistuese, përdorimi i tokës dhe infrastrukturës që und të preket nga aktivitete e projektit.

7. Mekanizmi i Ankesave

7.1. Prezantimi i mekanizmit

Ankesat mund të përfshijnë çdo ankimim, kërkesë ose sugjerim në lidhje me mënyrën se si po zbatohet një projekt. Ato mund të marrin formën e ankesave specifike për dëme / lëndime, shqetësime rreth aktiviteteve rutinë të Projektit, incidente ose ndikime të perceptuara. Identifikimi dhe përgjigjja ndaj ankesave mbështet zhvillimin e marrëdhënieve pozitive midis projekteve dhe komuniteteve lokale, dhe palëve të tjera të interesuara që mund të preken. Prandaj, mekanizmat e ankesave ofrojnë një rrugë formale dhe të vazhdueshme për palët e interesuara që të angazhohen me Zhvilluesin dhe Kontraktorin IPN, ndërkohë që monitorimi i ankesave jep sinjale për çdo konflikt ose mosmarrëveshje që lind.

Ky mekanizëm do të zhvillohet dhe hartohet në mënyrë të tillë që të jetë i përshtatshëm për grupet e palëve të interesit në mënyrë që të kuptojnë siç duhet çështjet e ardhshme dhe sfidat e komunikimit me të cilat mund të përballen në lidhje me zbatimin e projektit (p.sh., gjuha, nivelet e shkrim-leximit, niveli i aksesit në teknologji). Zhvilluesi dhe Konsulenti kanë informuar tashmë komunitetet lokale dhe palët e interesuara në lidhje me mekanizmin e ankesave gjatë procesit të VNMS-së. Ai do të zhvillohet më tej gjatë procesit të angazhimit të palëve të interesuara në të gjitha fazat e projektit, veçanërisht gjatë fazës së ndërtimit.

Ky mekanizëm ankesash do të pranojë dhe trajtojë të gjitha komentet dhe ankesat mbi ndikimet reale dhe ato të perceptuara në të njëjtën mënyrë dhe me të njëjtin nivel ose kujdes.

7.2. Përpunimi i Ankesave

Personat e prekur (PP) dhe të gjitha grupet e palëve të interesuara do të kenë mundësinë të paraqesin ankesa dhe pyetje për çdo aspekt të aktivitetit të Projektit dhe blerjes së tokës. Mekanizmi i Ankesave prezantohet gjatë të gjitha konsultimeve publike dhe publikohet në internet. Zhvilluesi do të sigurojë që ankesat për çdo aspekt ose çështje që mund të lindin të adresohen në kohë dhe në mënyrë të kënaqshme.

Të gjitha mundësitë janë vënë në dispozicion të PP-ve për të zgjidhur ankesat e tyre në nivel projekti. Sipas mekanizmit të ankesave në nivel projekti, familjet e prekura mund të apelojnë çdo vendim, praktikë ose aktivitet që lidhet me zgjidhjen e një anekse. PP-të do të ndërgjegjësohet për procedurat që mund të ndjekin për të kërkuar korrigjim, duke përfshirë, nëse është e nevojshme, përdorimin e procedurave administrative ose gjyqësore, si dhe mekanizmat e ankesave të huadhënësve. MA i projektit do t'u shpërndalet PP përmes takimeve konsultative, diskutimeve në grupe fokusi dhe intervista me informatorët kyç si dhe do të publikohet në faqen e internetit të Projektit.

Procesi i menaxhimit të ankesave është ilustruar në figurën më poshtë:




Figura 7: Procesi i Menaxhimit të Ankesave

7.3. Parashtrimi i ankesave

Një Formular i Ankesave Publike (të palëve të treta) do të përdoret për paraqitjen e ankesave. Ai do të jetë i disponueshëm në kopje fizike në administratën lokale (komunitetet lokale, komunat dhe zyrat rajonale), si dhe në një version elektronik në faqen e internetit të projektit. Megjithatë, letra të tjera të shkruara, e-mail, mesazhe me tekst dhe telefonata mund të përdoren gjithashtu për paraqitjen e ankesave, siç përshkruhet më poshtë. Palët e interesit dhe personat e prekur do të jenë në gjendje të paraqesin një ankesë në lidhje me projektin, në çdo kohë dhe pa kosto, duke përdorur një ose disa nga mënyrat e mëposhtme:

- Përmes formularit elektronik të ankesave në faqen e internetit të projektit: <https://karavastasolar.com/grievance/>
- Paraqitja e një ankese me shkrim ose verbale gjatë një takimi publik.
- Dorëzimi ose dërgimi me postë i një ankese me shkrim tek Ekipi i Menaxhimit Lokal ose Zyrtarit Ndërlidhës me Komunitetin (ZNK).
- Kontaktimi në telefon i Zyrtarit Ndërlidhës me Komunitetin (ZNK) përmes numrit të dedikuar të telefonit: +355684027034, ose dërgimit të një e-mail në karavasta@voltage.com.
- Përmes kutive të ankesave që do të dorëzohen në të gjitha pikat hyrëse në kantierin e projektit Karavasta.
- Përmes adresës postare ku mund të dërgohet forma e ankësës:
Bulevardi Bajram Curri, Qendra e biznesit European Trade Center ETC, Kati 9, Zyra 3, Tiranë, Shqipëri